



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr. 206/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e medias vendore “Alternativna”, me seli në Mitrovicë e Veriut, paraqitur kundër Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 09.10.2025, nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET e palejuar ankesa ZL.Anr. 206/2025, e parashtruar nga media vendore “Alternativna”, me seli në Mitrovicë e Veriut, paraqitur kundër Vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 09.10.2025, nga Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike, me të cilin është refuzuar kërkesa për akreditim të vëzhguesve për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 14.10.2025 PZAP-i, përmes postës ka pranuar një ankesë nga media vendore “Alternativna”, me seli në Mitrovicë e Veriut, në të cilën pretendon se më datë 09.10.2025, media vendore “Alternativna”, i kishte dorëzuar dëshminë e regjistrimit KQZ-së nga seanca në të cilën u vendos që ne të mos certifikohemi si vëzhgues. Alternativna është e regjistruar zyrtarisht si organizatë joqeveritare që nga viti 2019. Ajo ka një llogari bankare zyrtarisht të hapur dhe i plotëson të gjitha kriteret ligjore kur bëhet fjalë për pagesat e punonjësve dhe taksat, gjë që mund të verifikohet me një kontroll në sistem.

Parashtruesi i ankesës pretendon se këto veprime bien ndesh me disa dispozita ligjore në fuqi, konkretisht me LZP dhe rregullat zgjedhore.

Në përgjigje në kërkesë KQZ me datë 11.10.2025 kishte deklaruar se pas mbledhjes së KQZ-së e cila është mbajtur me datë 10.10.2025, Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) ka rekomanduar rivlerësimin e dokumentacioneve të aplikimeve të mediave për akreditim. Pas vlerësimit të

dokumentacioneve të dorëzuara me rastin e aplikimit të informatave në dispozicionet nga burimet: Këshilli i Pavarur për Media dhe Këshilli i Mediave të Shkruara në Kosovë, Zyra ka paraqitur rekomandim për KQZ për akreditimin e mediave vendore, “Radio KIM”, “R Media L.L.C”, “TV Gračanica D.O.O”, “Raporto24.com”, “Radio KM”, “TV MOST D.O.O”, “Kontakt Kosovska Mitrovica”, “Alternativna”, “RTV Puls D.O.O”, “Vendi Sot”, “Gračanicaonline.info”. KQZ pas këtij rekomandimi me datë 10.10.2025 ka mbajtur mbledhje po atë ditë përmes të cilës kanë akredituar mediat e lartcekura.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

KQZ me anë të përgjigjes në ankesë ka konfirmuar se me vendimin e datës 10.10.2025 pas rivlerësimit të dokumentacioneve të aplikimeve të mediave për akreditim, të njëjtat i ka akredituar, meqenëse të njëjtat i plotësojnë kushtet ligjore.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga media vendore “Alternativna”, me seli në Mitrovicë e Veriut, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën ZL.Anr.181/2025, të paraqitur me datën 10.10.2025, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZL.Anr.139/2025, të datës 11.10.2025.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, ZLAnr.139/2025 të datës 11.10.2025 dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli e hedhi ankesën.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 5 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.206/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.